REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/3869
Nr. i fax.
Data 04/06/2026

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 002/32
Datë: 29.05.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 29.05.2026 nxjerrë:

VENDIM

për inicimin e procedurave për plotësim-ndryshimin e "Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve"

I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme e Komunës së Junikut.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit
z.Leonard Hoffmann